



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
KABINETI

URDHËR

Nr. 2344 Datë 24.3 2017

PËR

**" MIRATIMIN E FORMULARIT TË APLIKIMIT DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN
E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET PËR TURIZMIN"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 31 të Ligjit nr. 93/2015, datë 27.07.2015, "Për Turizmin", pikës 8 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016, "Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit":

URDHËROJ:

1. Miratimin e Thirrjes për Projekt Propozime në fushën e turizmit, sipas formatit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Miratimin e Formularit të Aplikimit për Fonde për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet për turizmin sipas formatit bashkëlidhur këtij Urdhri.
3. Miratimin e Udhëzuesit për thirjen për projekt propozime, sipas formatit bashkëlidhur këtij Urdhri.
4. Publikimin e procedurës për përfitimin e mbështetjes financiare në lidhje me projektet për turizmin, në faqen zyrtare të MZHETTS, në media si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i MZHETTS për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

